



---

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA SUHAREKË  
OPSTINA SUVA REKA / MUNICIPALITY OF SUHAREKE  
ZYRA E PROKURIMIT  
PROCUREMENT OFFICE

**Nr: 006 /2022**

**Nr. Protokoli: 13/2022**

**Date: 11.03.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës **09.03.2022**, të parashtruar nga Operoret Ekonomik: **NERA MED nsht- Nexhmi Ademi B.I**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me barera** me Nr. të Prokurimi: **624-22-1168-1-1-1 & 624-022-021-111**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **09.03.2022**, e parashtruar nga Operoret Ekonomik: **NERA MED nsht- Nexhmi Ademi B.I**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me barera** me Nr. të Prokurimi: **624-22-1168-1-1-1 & 624-022-021-111**, kundër Njoftim për Kontratë e AK –së, të datës **25.02.2002** të publikuar në platformen elektronike.
  2. **Vërtetohet NJOFTIMI PER KONTRATË I AK i publikuar me datë: 25.02.2002.**
  3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
  4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
-

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **09.03.2022**, ka pranuar kërkesa për rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Furnizim me barera** me Nr. të Prokurimi: **624-22-1168-1-1-1 & 624-022-021-111**, kundër Njoftim per Kontratë të AK –së, të dates, **25.02.2002** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi ka pranuar kërkesën për rishqyrtim, ka kontaktuar njësinë e kërkesës dhe pasi kanë shqyrtuar dhe analizuar kërkesen tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë sepse:

-Vlera e parashikuar dhe sasi të vendosura janë përgaditur sipas çmimeve të tregut duke marr parasysh edhe ngritjen e çmimeve në treg.

-Sa i përket kërkesës së FDT-së që OE duhet të jetë i Licensuar për tregtimin e barnave, kjo kërkesë është ligjore dhe pavarësisht të OE a merren me tregtimin me shumicë apo pakicë, për ne si AK ata duhet të jenë të Licensuar, për më tepër në vlerësojmë se kemi zgjeruar konkurrencën konform LPP-së dhe u kemi dhënë mundësi më shumë OE për të konkuruar në këtë procedurë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

**Shef i Zyrës së Prokurimit**  
**Bujar Kuçi**

